



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:168185

Datë: 16.01.2025

Numri i dokumentit: 03338415

**C.nr.224/22**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, nga gjyqtarja Sabaheta Kurteshi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen civile sipas padisë së paditësit I. K. nga fsh..., Komuna e Dragashit, të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqeria e Avokatëve: Studio Ligjore&Financiare “K. As.” me avokatët e saj në Prishtinë, Ul. C-..., 2/..., kundër të paditurës Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të padisë për kompensimin e Inflacionit, jashtë seancës gjyqësore me dt. **16.01.2025** mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET pjesërisht** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit I. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit dhe DETYROHET e paditura Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit që në emër të kompensimit të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj shumën dhe atë:

1. Për periudhën kohore 01.08.2019 – 31.12.2019, në shumën prej 56.8 euro;
2. Për periudhën kohore 01.01.2020 – 31.12.2020, në shumën prej 10.10 euro;
3. Për periudhën kohore 01.01.2021 – 31.12.2021, në shumën prej 171.76 euro;
4. Për periudhën kohore 01.01.2022 – 21.11.2022, në shumën prej 537.19 euro.

**Në shumën e përgjithshme prej 775.85 (shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë euro e tetëdhjetë e pesë centi) euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (17.08.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit.

**II. REFUZOHET** e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit e kërkuar më shumë se shuma e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sa i përket kompensimit të inflacionit vjetor për periudhën prill 2017 – gusht 2019 në shumën prej 191.24 euro.

**III. DETYROHET** e paditura Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 euro.

**A r s y e t i m**

Nga ana e paditësit I. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit, të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqeria e Avokatëve: Studio Ligjore&Financiare “K. Ass.” me avokatët e saj në Prishtinë, është paraqitur padia kundër të paditurës Komuna e Dragashit – DKA-së në Dragash, për shkak të kompensimit të Inflacionit, ku ka theksuar se e drejta materiale e paditësit konsiston në Kontratën

Kolektive të Arsimit në Kosovë, e nënshkruar me datë 18.04.2017, ku paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, dhe të njëjtit i takon kompensimi mbi bazën e inflacionit. Paditësi, me datë 26.12.2024, kanë precizuar kërkesëpadinë, duke kërkuar nga gjykata aprovimin e së njëjtës dhe duke detyruar të paditurën në emër të inflacionit për periudhën kohore 2017 - 2022, shumën e përgjithshme prej prej 967.09 €, të gjitha me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë datë 17.08.2022 e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, për arsye se fitimi i të drejtave të cilat rrjedhin nga kontrata kolektive e arsimit e nënshkruar me datë 18.04.2017 dhe 22.01.2021 në mes të paleve nuk është arritur marrëveshja për kompensim të inflacionit. Prandaj duke u bazuar se kontratës kolektive me shënime si më lartë i ka skaduar afati, kjo kërkesëpadi është e Parashkruar, andaj i propozojmë gjykatës që padinë e paditësit ta refuzoj si jo të bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8, 398 dhe 399.1 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, por se e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit si dhe faktit në lidhje me parashkrimin e kërkesëpadisë së paditësit. Në këtë rast kontestues është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance, për arsye se:

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës me numër protokollit 13/586-18 e datës 01.09.2016, për paditësin e lëshuar nga Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHFMU “Sh. Sh.” me seli në..., Komuna e Dragashit, në cilësi të mësimdhënësit klasor. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësit e që është shuma prej 421, ndërsa në bazë të vërtetimit Nr.338/24 të dt. 26.12.2024 të lëshuar nga SHFMU “Sh. Sh.” në Ll. gjykata vërteton faktin se paditësi është i punësuar në këtë shkollë që nga data 01.03.1994 dhe ende vazhdon të punon pranë kësaj shkolle si mësimdhënës klasor. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”.

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësi nuk ka pranuar kompensimin në pagë në emër të inflacionit vjetor, në kohën sa ka qenë në fuqi KKAK.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Për periudhën 01.01.2019 deri 31.12.2019 ka qenë 2.7%, andaj ka llogaritur pagën bazë të paditësit (paga 421.00€ x 2.7%=12.39€) shumëzuar për 5 muaj përfitohet shuma 56,8€, për periudhën kohore 01.01.2020 deri 31.12.2020 ka qenë 0.2% andaj ka llogaritur pagën bazë të paditësit (paga 421.00€ x 0.2%=0.84€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 10.10€, për periudhën kohore 01.01.2021 deri 31.12.2021 ka qenë 3.4% andaj ka llogaritur pagën bazë të paditësit (paga 421.00€ x 3.4%=14.31 €) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 171.76€, për periudhën kohore 01.01.2022 deri 22.11.2022 ka qenë 10.4% andaj ka llogaritur pagën bazë të paditësit (paga 421.00€ x 11.6%=48.836€) shumëzuar për 11 muaj përfitohet shuma 537.19 €.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese si në pikën nën II, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399.1 të LPK-së ku shprehimisht theksohet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu sipas nenit 87 të Ligjit të Punës shprehimisht theksohet që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 17.08.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës për periudhën Prill 2017 deri më datë 17 gusht 2019. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 28 muaj apo në shumën prej 191.24 euro, ndërsa paditësi e ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe e ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë respektivisht nga data 17.08.2022.

Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit sikurse në pikën nën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*, e do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë, datë 17.08.2022. Ndërsa shuma e përlllogaritur nga pala paditëse sipas parashtrësës për precizim e dt. 26.12.2024, gjykata nuk e mori në konsiderat, ngase një përlllogaritje e tillë është e parakohshme ndërsa kjo përderisa çështja ende nuk ka marrë formën e prerë dhe nuk është paraqitur për permbarim.

Gjykata vendosi si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 124 €, në kuptim të nenit 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve i referohet taksës gjyqësore në shumën prej 20€ dhe shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 104€ - sipas tarifës së OAK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
C.nr.224/22 e dt. 16.01.2025**

**G j y q t a r j a,**

**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.